

Rudolf Papa

Mban pozicionin e Këshilltarit të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave. Është diplomuar si jurist në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Gjatë viteve 1995 – 2003 ka zhvilluar një karrierë të suksesshme në drejtimin dhe menaxhimin e aktiviteteve tregtare pranë shoqërisë VeVE Group, duke arritur deri në nivelin më të lartë të drejtimit të shoqërisë si Drejtor Ekzekutiv i këtij grupi. Më pas ka dhënë kontributin e tij në institucionet publike, ku ka qenë i angazhuar pranë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, më pas Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Nga viti 2013 deri në vitin 2018 ushtroi detyrën e drejtorit të kabinetit të Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP. Në periudhën 2019-2021 ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze, italiane dhe greke.

Fushat e Angazhimit: *Çështjet Ekonomike, Tregjet e Kapitalit, monitorimi i veprimtarisë së Institucioneve të Varësisë .*

Rudolf.Papa@financa.gov.al